

NEWSLETTER

Dhjetor

Albsig merr pjesë në “Ping Pong Business Tournament” dhe promovon rëndësinë e sportit në komunitetin e biznesit.

Albsig në Downtown One: Një epokë e re, për një lider 20 vjeçar.

Albsig: Lider në produkte vullnetare, rritje e qëndrueshme dhe shpejtësi rekord në pagesën e dëmeve.

Albsig Jetë: Lider në sigurimet e jetës me performancë të shkëlqyer dhe rritje rekord në pagesën e dëmeve.

Albsig Investon në veshje për fëmijët me aftësi ndryshe në qendrën “Zëra Jete” në Elbasan!

Albsig, festat e fundvitit: Koha për të reflektuar, falënderuar dhe festuar!”



PJESË E  KASTRATI GROUP

Shoqëria e Sigurimit Albsig sh.a., pjesë e Grupit KASTRATI, ushtron aktivitet të suksesshëm që nga viti 2004, në cilësinë e siguruesit të Jo - Jetës. Me një rrjet me 28 degë, Albsig mbulon territorin e Republikës së Shqipërisë. Albsig mbështetet në stafin e dedikuar dhe profesional dhe ofron shërbim të shpejtë dhe cilësor.

VIZIONI

Klienti, prioriteti ynë. Ne tejkalojmë pritshmëritë e tij përmes shërbimit, integritetit dhe profesionalizmit.

MISIONI

Të jemi zgjedhja e parë e çdo klienti. Ne rritemi bashkë me klientët tanë.

FILOZOFIA

Besim dhe solidaritet me klientët për të arritur suksesin e përbashkët.



Partneri juaj i sigurtë!




PJESË E  KASTRATI GROUP

Albsig merr pjesë në “Ping Pong Business Tournament” dhe promovon rëndësinë e sportit në komunitetin e biznesit.

Më 8 dhjetor 2024, Albsig, si pjesë e Kastrati Energy Trade, ishte pjesëmarrëse në edicionin e radhës të “Ping Pong Business Tournament,” një ngjarje e veçantë që u zhvillua në Pallatin e Rinisë. Ky aktivitet sportiv shënoi jo vetëm një platformë për kompeticion, por edhe një hapësirë për të forcuar marrëdhëniet mes kompanive dhe për të promovuar vlerat e shëndetit dhe mirëqenies përmes sportit. Pjesëmarrja e Albsig në këtë turne merr një rëndësi të veçantë, veçanërisht këtë vit kur kompania feston 20-vjetorin e saj. Kjo ngjarje është një mundësi për të theksuar angazhimin e Albsig në përkrahjen e iniciativave që ndërthurin aktivitetet sportive dhe komunitare, duke theksuar rolin e rëndësishëm të sportit si një faktor kyç për shëndetin fizik dhe mendor, si për individët, ashtu edhe për kolektivat e kompanive.

Sportet si ping-pongu, përveçse ndihmojnë në ndërtimin e një stili të shëndetshëm jetese, ofrojnë një mënyrë të shkëlqyer për të forcuar ekipet brenda organizatave dhe për të nxitur bashkëpunimin mes kompanive në një ambient të qetë dhe argëtues. Për Albsig, përfshirja në aktivitete të tilla reflekton vizionin e saj për të mbështetur jo vetëm klientët, por edhe punonjësit dhe komunitetin më të gjerë, duke promovuar vlera pozitive dhe një qasje holistike ndaj biznesit dhe shoqërisë. Turneu u organizua nga 11 Points dhe Priping, dhe pritet të mirëpresë pjesëmarrës nga kompani të ndryshme që ndajnë të njëjtën frymë sportiviteti dhe miqësie. Me sloganin e saj të përkushtimit dhe suksesit ndër vite, Albsig do të jetë një ndër shembujt kryesorë të harmonizimit të biznesit me përgjegjësinë sociale.



Albsig në Downtown One: Një epokë e re, për një lider 20 vjeçar.

Nëntori sjell fetstat kuq e zi në Albsig. Krahas festave kombëtare në këtë muaj Albsig feston dhe përvjetorin e themelimit të saj. Konkretisht më datën 25 nëntor, Albsig shënon një moment të rëndësishëm në historinë e saj: 20-vjetorin e themelimit. Ky përvjetor simbolizon më shumë se një rrugëtim kohor; është dëshmi e përkushtimit të vazhdueshëm për të ofruar produkte dhe shërbime të sigurimit me standarde të larta dhe për të ndërtuar besim tek mijëra klientë në mbarë Shqipërinë.

20 vite rritje dhe konsolidim

E themeluar në vitin 2004, Albsig e nisi rrugëtimin e saj me përkushtim të palëkundur, duke arritur të jetë ndër 4 kompanitë kryesore të tregut që në dekadën e parë të stardit saj. Përmes rritjes së qëndrueshme dhe besimit të klientëve, në vitin 2014 arriti mbi 1 miliardë lekë prime, duke zënë një pozicion të fortë në treg. Pikërisht sot, në vitin e 20-të të veprimtarisë, Albsig qëndron e konsoliduar në vendin e dytë në tregun e sigurimeve, me një kuotë tregu prej rreth 20%. Por, sukseset nuk ndalen këtu. Për disa produkte strategjike, si sigurimi i përgjegjësiwe civile dhe në ndërtim, Albsig është lideri i padiskutueshëm.

Shpejtësia në shërbim: Besnikëri ndaj klientit

Një nga vlerat që e ka bërë Albsig të veçohet në treg është shpejtësia në pagesën e dëmeve. Ky është thelbi i çdo kompanie sigurimesh, dhe Albsig e ka bërë këtë parim pjesë të ADN-së së saj. Në raste kritike, si pas dy tërmeteve të vitit 2019, kompania mbylli 90% të praktikave në kohë rekord, duke treguar përkushtimin ndaj klientëve në momentet më të vështira. Aktualisht, me vetëm 356 dosje pezull deri në fund të tetorit 2024 dhe një numër minimal çështjesh gjyqësore (vetëm 37), Albsig vazhdon të tregojë se nuk është një kompani që klientët i lë të presin. Përkundrazi, është sinonim i besimit dhe korrektësisë në çdo moment.

Nisi me një buzëqeshje dhe vazhdon me një hap drejt së ardhmes, me vlera që na bashkojnë.

Transferimi në "Downtown One" nuk është vetëm ndryshim fizik. Është një deklaratë për të ardhmen: Albsig synon të jetë një kompani më moderne, më inovative dhe më pranë klientëve të saj, duke sjellë shërbime të standardeve më të larta.



Albsig: Lider në produkte vullnetare, rritje e qëndrueshme dhe shpejtësi rekord në pagesën e dëmeve

Në përfundim të 10-mujorit të vitit 2024, ALBSIG SH.A. konfirmon pozicionin e saj si një nga kompanitë më të rëndësishme dhe më të besueshme në tregun shqiptar të sigurimeve. Me një pjesëmarrje prej 19.07% në treg dhe një rritje prej 4.82% krahasuar me veten, ALBSIG ka dëshmuar një strategji të suksesshme që kombinon rritjen e qëndrueshme me përkushtimin ndaj cilësisë së shërbimeve dhe inovacionit në produktet e saj. Këto rezultate reflektojnë një përmirësim të vazhdueshëm në qasjen ndaj klientëve dhe tregut të sigurimeve në Shqipëri.

Albsig me produkte e shërbime që bëjnë diferencën, lider në produkte vullnetare.

Një nga arritjet më të dukshme të ALBSIG për këtë periudhë është pozicionimi i saj si lider absolut në segmentin e produkteve vullnetare, me një raport prej 53.41%, shumë më i lartë se mesatarja e tregut prej 33.89%. Ky rezultat tregon jo vetëm përkushtimin e kompanisë për të ofruar produkte të personalizuar, por edhe aftësinë për të ndërtuar marrëdhënie afatgjata me klientët.

Produktet vullnetare të ALBSIG përfshijnë një gamë të gjerë shërbimesh që plotësojnë nevojat e individëve dhe bizneseve, duke përfshirë: Sigurimi Kasko i cili ofron mbrojtje gjithëpërfshirëse për automjetet, duke përfshirë dëmet nga aksidentet, e fatkeqësitë natyrore. Pasuar nga ky produkt me një pjesëmarrje prej 36.89% të tregut, ALBSIG kryeson në këtë kategori, duke u bërë zgjedhja e parë për pronarët e automjeteve. Ndërsa për Sigurimin e Përgjegjësisë Civile, ALBSIG është lider me një pjesëmarrje prej 32.29% të tregut. Ky produkt mbulon dëmet që mund të shkaktohen palëve të treta nga klientët, duke u ofruar atyre siguri financiare dhe ligjore. Referuar statistikave të buletinit zyrtar të AMF theksohet se ALbsig në produktet e Sigurimit e Sëmundjeve, zë 23.85% të tregut.

ALBSIG tregon se është një nga liderët e tregut në këtë segment, duke ofruar mbulim shëndetësor për individët dhe familjet. Ky produkt ka luajtur një rol të rëndësishëm në përmirësimin e qasjes së qytetarëve ndaj kujdesit shëndetësor. Duke qenë lider në sigurimet vullnetare Albsig në grupin e produkteve të Sigurimit të Pronës (Zjarri dhe Dëmtimet në Pronë) zë 26.37% të tregut, ALBSIG renditet në vendin e dytë, duke ofruar mbrojtje për prona nga zjarri, vjedhjet dhe fatkeqësitë natyrore. Jo vetëm kaq, por tek sigurimi i garancive, ALBSIG është lider absolut në këtë segment me një pjesëmarrje prej 50.10% të tregut. Ky produkt është thelbësor për kompanitë që kërkojnë të sigurojnë kontrata dhe projekte të rëndësishme.

Shpejtësi dhe efikasitet në pagesën e dëmeve.

Një nga elementët më të fortë të performancës së ALBSIG është shpejtësia dhe cilësia e shërbimit në trajtimin e dëmeve. Kompania ka numrin më të ulët të dëmeve të pezulluara në fund të 10-mujorit 2024, me 356 dosje dësmesh, duke dëshmuar një proces të shkëlqyer menaxhimi dhe transparencë të plotë. Shërbimi i shpejtë dhe efikas i trajtimit të dëmeve është bërë një pikë referimi në tregun e sigurimeve, duke forcuar besimin e klientëve dhe partnerëve të kompanisë. Kujtojmë këtu menaxhimin në kohë rekord të dëmeve të dy tërmeteve të vitit 2019, ku Albsig dëmshpërbleu çdo klient të saj. Jo vetëm kaq, por vetëm para pak ditësh Albsig bëri të mundur menaxhimin e një dëmi të konsiderueshëm në spitalin e qytetit të Pukës.



ALBSIG: Një lider i padiskutueshëm në kategoritë kyçe të tregut

Përveç suksesit në produktet vullnetare, ALBSIG ka konsoliduar pozicionin e saj si lider ose si një nga kompanitë më të rëndësishme në kategori të tjera kyçe të sigurimeve, duke përfshirë këtu sigurimin Kasko ku ky sigurim mbulon të gjitha aspektet e nevojave të pronarëve të automjeteve. Ndërkaq vlen të theksohet dhe sigurimi i Përgjegjësisë së Ndërtuesit, i cili garanton standarde të larta sigurie në sektorin e ndërtimit, një fushë gjithnjë e më e rëndësishme për ekonominë shqiptare. Këtij grupi produktesh u shtohet dhe Sigurimi i Garancive, një produkt kyç që mbështet zhvillimin ekonomik dhe projektet madhore në sektorë të ndryshëm.

Një qasje e bazuar në qëndrueshmëri dhe inovacion

Rezultatet e arritura nga ALBSIG për periudhën janar-tetor 2024 dëshmojnë përkushtimin e kompanisë për të kombinuar qëndrueshmërinë me inovacionin. Përveç arritjes së rezultateve të shkëlqyera financiare, ALBSIG vazhdon të përmirësojë përvojën e klientit duke ofruar produkte të reja dhe duke investuar në teknologji që i bëjnë shërbimet më të aksesueshme dhe më efikase.

Në një treg gjithnjë e më konkurrues, ALBSIG mbetet një emër i pakrahasueshëm në industrinë e sigurimeve në Shqipëri. Me një qasje që vendos klientin në qendër, kompania vazhdon të jetë një partner i besueshëm dhe një lider në fushën e sigurimeve. E ardhmja premtan shumë për ALBSIG dhe klientët e saj, me një vizion të qartë për të ngritur standardet e industrisë dhe për të vazhduar të jetë sinonim i besueshmërisë dhe cilësisë.

Albsig Jetë: Lider në sigurimet e jetës me performancë të shkëlqyer dhe rritje rekord në pagesën e dëmeve

Për periudhën janar-tetor 2024, ALBSIG Jetë konfirmohet si një nga aktorët kryesorë në tregun e sigurimeve të jetës në Shqipëri, duke u renditur në vendin e dytë bazuar në statistikat e AMF, me një pjesëmarrje prej 24.68% në treg. Kompania ka shënuar një rritje të jashtëzakonshme prej 50.62% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, duke forcuar pozitën e saj si një nga ofruesit më të besueshëm dhe inovativë të sigurimeve të jetës.

Performancë impresionuese në “Jetën e Debitorit”

ALBSIG Jetë ka spikatur veçanërisht në segmentin e sigurimeve për jetën e debitorit, duke zënë 26.98% të tregut për periudhën janar-tetor 2024. Ky produkt thelbësor siguron mbrojtje financiare për institucionet bankare dhe klientët individualë, duke mbuluar detyrimet financiare në rastet e paparashikuara.

Dëmet: Pagesa të shpejta dhe efikase

ALBSIG Jetë është gjithashtu ndër liderët në treg për menaxhimin dhe pagesën e dëmeve. Për periudhën 10-mujore të vitit 2024, kompania ka shfaqur efikasitet maksimal në trajtimin e dëmeve, duke garantuar që të gjitha pretendimet të zgjidhen në kohë rekord dhe me transparencë të plotë. Ky angazhim ka rezultuar në një numër minimal të dëmeve pezull, duke forcuar më tej reputacionin e kompanisë si një partner i besueshëm për klientët.



Faktorët kyç të suksesit të Albsig Jetë

- 1. Rritja më e madhe në treg:** Një rritje prej 50.62% e tregon ALBSIG Jetë si liderin absolut në përmirësimin e performancës së saj brenda një viti.
- 2. Produkte të përshtatura:** Ofrimi i produkteve inovative dhe të personalizuar, si sigurimi i jetës së debitorit, plane të kursimeve afatgjata dhe mbrojtje financiare për familjet, ka qenë çelësi i suksesit.
- 3. Shërbim cilësor:** Pagesa të shpejta dhe trajtim i drejtpërdrejtë i dëmeve kanë bërë ALBSIG Jetë sinonim të cilësisë dhe besueshmërisë në tregun shqiptar të sigurimeve.

Si Albsig Jetë ndikon në tregun e sigurimeve?

Lider në inovacion: ALBSIG Jetë vazhdon të zhvillojë produkte të reja për të përmbushur nevojat në ndryshim të individëve dhe bizneseve.

Besueshmëri në treg: Një raport i lartë i pagimit të dëmeve dhe komunikimi i vazhdueshëm me klientët e ka bërë ALBSIG Jetë një zgjedhje të preferuar për klientët individualë dhe institucionet financiare.

Kontribut në ekonominë shqiptare: Produktet e sigurimit të jetës ndihmojnë individët dhe familjet të ndërtojnë një të ardhme më të sigurt financiare.

E Ardhmja: Strategjia për rritje dhe zgjerim

ALBSIG Jetë ka spikatur veçanërisht në segmentin e sigurimeve për jetën e debitorit, duke zënë 26.98% të tregut për periudhën janar-tetor 2024. Ky produkt thelbësor siguron mbrojtje financiare për institucionet bankare dhe klientët individualë, duke mbuluar detyrimet financiare në rastet e paparashikuara.

Me bazë të fortë dhe rezultate të shkëlqyera, ALBSIG Jetë synon të ruajë ritmin e rritjes duke:

- Futur më shumë produkte inovative në tregun e sigurimeve të jetës.
- Përmirësuar më tej proceset për trajtimin dhe pagesën e dëmeve.
- Zgjeruar edukimin e klientëve për përfitimet e sigurimit të jetës dhe të mbrojtjes financiare afatgjatë.

Në një treg gjithnjë e më konkurrues, ALBSIG Jetë konfirmohet si një partner i besueshëm dhe lider në ofrimin e zgjidhjeve të sigurimit të jetës. Me një qasje të bazuar në rritje, inovacion dhe përkushtim ndaj klientëve, ALBSIG Jetë është në rrugën e duhur për të vazhduar të udhëheqë tregun dhe të forcojë pozicionin e saj si një nga kompanitë më të besuara të sigurimeve në Shqipëri.





Albsig Investon në veshje për fëmijët me aftësi ndryshe në qendrën “Zëra Jete” në Elbasan!

Një prekje humaniteti që sjell ngrohtësi dhe shpresë. Në një akt domethënës solidariteti dhe përkujdesjeje, Albsig ka ndërmarrë një iniciativë mbresëlënëse për të mbështetur fëmijët me aftësi ndryshe që frekuentojnë qendrën “Zëra Jete” në Elbasan. Ky investim i kompanisë nuk është vetëm një ndihmë praktike, por një mesazh i qartë për një shoqëri që duhet të jetë më përfshirëse dhe më e drejtë për të gjithë.

Zëra që duhen dëgjuar: Përse ky investim ka rëndësi?

Fëmijët me aftësi ndryshe shpesh përballen me sfida të shumta në përditshmërinë e tyre, duke përfshirë vështirësitë ekonomike dhe sociale. Përmes këtij gjesti human, Albsig ka sjellë një frymë të re solidariteti në jetën e tyre. Investimi në veshje cilësore jo vetëm që i ndihmon ata të përballen me nevojat e përditshme, por gjithashtu i fuqizon duke rritur vetëbesimin dhe ndjenjën e përkatësisë. Për fëmijët në “Zëra Jete”, veshjet e reja përfaqësojnë më shumë se thjesht një dhuratë materiale. Ato janë një simbol i mbështetjes, dashurisë dhe pranimit nga një kompani që sheh përtej detyrimeve të saj komerciale dhe kontribuon në mirëqenien e komunitetit.

Një ceremoni e mbushur me emocione

Në qendrën “Zëra Jete” u zhvillua një aktivitet i veçantë, ku përfaqësues të Albsig shpërndanë veshje për fëmijët, duke e kthyer këtë ditë në një moment të paharrueshëm për ta. Atmosfera ishte e mbushur me buzëqeshje, përqafime dhe ndjenja mirënjohjeje, duke treguar ndikimin e madh që një akt i tillë ka në jetën e këtyre fëmijëve dhe familjeve të tyre. “Ne besojmë se kujdesi për fëmijët është investimi më i vlefshëm që mund të bëjmë si kompani dhe si shoqëri. Fëmijët me aftësi ndryshe meritojnë dashurinë dhe mbështetjen tonë për të ndërtuar një të ardhme ku ata ndihen të barabartë dhe të vlerësuar.” u shpreh një nga përfaqësuesit e marketingut të Albsig.

Albsig: Një model i përgjegjësisë sociale

Kjo nismë nuk është një rastësi, por pjesë e vizionit afatgjatë të Albsig për të kontribuar në një shoqëri më të barabartë. Kompania ka qenë gjithmonë e angazhuar përtej sigurimeve, duke investuar në kauza që mbështesin komunitetet në nevojë dhe që promovojnë solidaritetin dhe përfshirjen sociale. Përmes këtij projekti, Albsig shpalos një shembull të fuqishëm se si bizneset mund të luajnë një rol kyç në përmirësimin e jetës së njerëzve, duke ndihmuar ata që kanë më shumë nevojë dhe duke ndërtuar ura komunikimi dhe mirëkuptimi në shoqëri.

Një thirrje për veprim

Iniciativa e Albsig është një ftesë për të gjithë aktorët e tjerë të shoqërisë — bizneset, organizatat dhe individët — që të bashkohen në përpjekjet për të krijuar një botë më të mirë për fëmijët me aftësi ndryshe. Kujdesi dhe mbështetja për këta fëmijë janë jo vetëm një detyrë morale, por edhe një mundësi për të ndërtuar një të ardhme ku diversiteti vlerësohet dhe fuqizohet.

Një hap përpara drejt një të ardhmeje më të ndritur

Përmes këtij akti domethënës, Albsig ka treguar se ndryshimi fillon nga gjestet e vogla, por me ndikim të madh. Mbështetja e ofruar për fëmijët e qendrës “Zëra Jete” nuk është thjesht një dhuratë, por një investim në dinjitetin, lumturinë dhe të ardhmen e tyre. “Një shoqëri e fortë ndërtohet duke kujdesur për ata që kanë më shumë nevojë. Albsig, gjithmonë pranë komunitetit!”





Albsig, festat e fundvitit: Koha për të reflektuar, falënderuar dhe festuar!”



Ndërsa afrohet fundi i vitit, në Albsig ndiejmë krenari dhe mirënjohje për gjithçka që kemi arritur së bashku. Viti 2024 ka qenë një vit sfidash dhe arritjesh të mëdha, një vit ku kemi përforcuar vlerat tona dhe kemi qenë pranë klientëve tanë në çdo hap. Viti ku veçoi Albsig-un si kompania e vetme në tregun e sigurimeve që edukon konsumatorët për rëndesinë e produkteve vullnetare. Është shoqëria e vetme në treg që ka numrin më të vogël të dëmeve pezull, dhe shumë detaje të tjera që bëjnë diferencën. Fundviti asnjëherë nuk ka kuptim pa festën tradicionale që realizohet çdo vit me stafin e kompanisë. Edhe këtë vit ndryshe nga vitet e tjera Albsig organizoj festën tradicionale në Hotel Continental Vorë. Festa u organizua me kujdes dhe shkoi shumë mirë.

Siç edhe e do tradita, nuk mungoi dhe mesazhi i veçantë nga Drejtori i Përgjithshëm i Albsig. Ai ndau një urim të përzemërt për të gjithë bashkëudhëtarët e suksesit të Albsig. **“Të dashur kolegë, partnerë dhe miq të Albsig, Në këtë fundvit të mrekullueshëm, dua të shpreh mirënjohjen time të thellë për përkushtimin dhe besimin tuaj. Ju jeni forca dhe frymëzimi ynë për të ndërtuar një të ardhme më të sigurt për të gjithë. Uroj që ky vit i ri të sjellë gëzim, lumturi dhe shëndet për ju dhe të dashurit tuaj. Së bashku, do të vazhdojmë të bëjmë diferencën! Gëzuar Festat dhe Vitin e Ri!”**, tha z. Muharrem Bardhoci, Drejtor i Përgjithshëm i Albsig.sh.a në mesazhin falenderues në festën e fundvitit për stafin e Albsig.


Mbrëmja e madhe dhe surpriza e vitit

Në Albsig mbrëmja festive nuk është thjesht një moment për të festuar — është një mundësi për të ndarë gëzimin dhe për të shpërblyer besimin dhe përkushtimin ndaj çdo punonjësi duke përfshirë çdo hallkë të kompanive. Festa tradicionale është një ndër momentet më delikate dhe më të rëndësishme të Albsig. Me pjesëmarrjen e Sidrit Bejlerit dhe Denisa Xhezos, stafi i Albsig kaluan një mbrëmje të paharrueshme. Por jo vetëm kaq përveç këngëve popullore nuk mungoi dhe kërcimi latin me mjeshttrat e balerinëve të këtij zhanri. Festa nisi me një atmosferë e ngrohtë dhe më pas mbrëmja përfshiu shorteun e madh, ku pjesëmarrësit fituan çmime fantastike. Por, festa dhe shorteu nuk u mbyll me kaq, ndryshe nga vitet e tjera këtë vit, duke përkuar edhe me një vit jubilee siç ishte 20-vjetori i Albsig u bë një shorte i veçantë me një çmim të madh prej 3000 EURO! Po, e keni dëgjuar saktë! Agron Duraku, punonjës në degën Albsig Fier u largua nga mbrëmja e fundvitit me një dhuratë të jashtëzakonshme, të pamenduar më parë, me një shpërblim prej 3000 eurosh, si një mënyrë simbolike për të thënë faleminderit për kontributin e tij dhe për të përmbyllur këtë vit në mënyrën më të bukur të mundshme.

Së bashku drejt një viti të ri plot suksese

Ndërsa festojmë fundvitin, nuk mund të mos shohim me entuziazëm drejt 2025–ës. Me të njëjtin përkushtim dhe vizion, Albsig mbetet e përkushtuar për të sjellë inovacion dhe siguri në jetën tuaj. Le të festojmë këtë fundvit si një familje e madhe dhe të presim vitin e ri me zemër të hapur. Faleminderit që jeni pjesë e udhëtimit tonë.





 +355 (0) 42254770 / 764

 info@albsig.al

WWW.ALBSIG.AL